

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K.) “ UNIEURO ”sh.p.k.

Sot me dt.06.2007, ne shtetasit shqiptarë:

1- Altin BEJKO, i biri i Avdylit dhe Engjellushes , i dtl.1974, banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

2- Arjan Gjyzeli, i dt 1.1974, i biri Skenderit dhe Hatixhes lindur dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

mbështetur në dispozitat e ligjit nr.7512, dt.10/8/1991 dhe ligjit nr.7638, dt.19/11/1992, vendosëm krijimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “UNIEURO”sh.p.k. sipas Akt-Themelimit të mëposhtëm:

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “UNIEURO ”sh.p.k..

Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët dhe filialet që mund të krijohen, do t'i nënshtrohen legjislacionit të vëndit ku do të ketë selinë, dega apo filiali.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të Akt-Themelimit dhe Statutit të shoqërisë, që do të miratohet e nënshkruar nga ortakët themelues.

Problemet që nuk do të jenë trajtuar shprehimisht në statut, do të trajtohen sipas ligjit nr.7638, dt.19/11/1992.

Vend-Qëndrimi i Shoqërisë

Neni 2

Vend-Qëndrimi i Shoqërisë (Selia), do të jetë në qytetin e Durrësit, Lagjja 17, Rruga “Hysen Kertusha” ish U.R.T.

Në vartësi të aktivitetit të saj tregtar e fitimprurës, shoqëria mund të hapë degë apo filiale brënda apo jashtë vëndit, në përputhje me legjislacioni përkatës.

Objekti i Veprimtarisë

Neni 3

Objekti i vepimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import-eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.
- Prodhim e tregtim konfeksionesh te te gjitha llojeve.
- Tregtim artikujsh te ndyshme industriale.
- Tregtim artikujsh te ndryshem ushqimore.
- Tregtim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim.



- Tregëtim paisjesh elektroshtepiake, kompjuterike, higjenosanitare, prodhime qeramike, artizanati etj.
- Tregëtimin e pllakave.
- Transport mallrash dhe pasagjerësh brenda dhe jashte vendit.
- Tregëtimin e materialeve të ndërtimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit.
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Punime duroalumini e tregëtimin e tyre.
- Punime druri, tregëtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje. orendi, dyer, dritare etj.
- Stampim faqe letre dhe amballazhe të tipeve të ndryshme
- Pergatitje zarfesh letre
- Ngjitje dhe pergatitje zarfesh plastik dhe amballazhe të tipeve të ndryshme, me proces stampimi me shtypje në të nxehtë.
- Shitje me pakice dhe shumice artikujsh publicitare zarfesh prej letre, kartoni dhe plastik dhe materiale për amballazhim të tipeve të ndryshme
- Import-eksport kafshesh dhe shpendesh te gjalla.

Neni 4

Shtimi apo pakësimi i veprimtarisë së shoqërisë, ndërrimi i emrit apo i vënd-qëndrimit të saj do të bëhet në mënyrën e parashikuar në ligj, duke pasqyruar këto ndryshime në Rregjistrin Tregtar.

Neni 5

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hapë objekte e njësi shërbimi e përpunimi dhe do të bashkëpunojë me persona juridikë dhe fizikë, vendas apo të huaj.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e papërcaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë, për çfarëdo lloj shkakut, vetëm me marrveshje të të gjithë ortakëve, ose në raste të parashikuar me ligj. Kur marrveshja nuk arrihet, prishja e shoqërisë do të vendoset nga gjykata.

Kapitali Shoqërisë

Neni 7



Kapitali i shoqërisë (kapitali themeltar), do të jetë në shumën 100.000 lekë. Kapitali themeltor zotërohet nga ortakët si më poshtë:

1-Altin Bejko 50 %

2-Arjan Gjyzeli 50 %

Kapitali themeltar ndahet në pjesë të barabarta nga 1.000 (njëmijë) lekë, ose shumëfishin e saj. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali fillestar mund të shtohet me vendim të ortakëve themelues, sipas mënyrës së përcaktuar në statut dhe në ligjin bazë.

Neni 8

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, do të ndahet në raport me përqëndjet e kapitalit, midis ortakëve themelues. Shoqëria nga fitimi neto, cakton një fond rezervë.

Neni 9

Ortakët përballojnë nga humbjet, vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin fillestar.

Shoqëria nuk përgjigjet për borxhet apo detyrimet e mëparshme të ortakëve, si edhe ato që mund të krijohen, si rezultat i ndonjë veprimtarie tjetër të ortakëve, jashtë asaj të shoqërisë.

Neni 10

Për regjistrimin e kapitalit themeltar, shoqëria do të hapë librin e llogarisë. Ajo do të pasqyrojë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera, bilancin 6 mujor e vjetor dhe të gjithë aktivitetin e tij financiar.

Neni 11

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje, për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e shoqërisë dhe të mos dëmtojnë interesat e shoqërisë dhe të personave të tretë.

Drejtimi i shoqërisë

Neni 12

Shoqëria do të administrohet nga ortaku themelues Altin BEJKO, I cili ngarkohet që të kryejë dhe ndjeko të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e shoqërisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kompetencat e administratorit, do të përcaktohen hollësisht në statutin e shoqërisë, sipas neneve 16 e 50 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Ortakët në marrveshje mes tyre, mund të caktojnë edhe persona fizikë të jashtëm, që nuk janë ortakë, me cilësinë e administratorit..

Kur marrveshja nuk arrihet, zbatohen dispozitat e nenit 50 të ligjit bazë.

Organi i më lartë drejtues i shoqërisë, është Asambleja e Ortakëve.

Asambleja e ortakëve vendos për çështjet themelore të shoqërisë. Për funksionimin e saj respektohen kërkesat e neneve 57 e vijues të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Kompetencat e asamblesë së ortakëve, përcaktohen hollësisht në statutin e shoqërisë.

Neni 13

Ortakët themelues, kanë të drejtë të caktojnë financiarë apo likuidatorë, për problemet e shoqërisë, si dhe të pranojnë persona të tjerë si ortakë në shoqëri.

Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiarë, 3 mujorë, 6 mujorë dhe vjetorë, për aktivitetin e kryer nga shoqëria.

Marëdhëniet e punësimit

Neni 14

Për kryerjen e aktivitetit të saj tregtar, shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë apo punëtorë, shtetas shqiptarë apo të huaj. Mardhëniet e punësimit do të rregullohen sipas kontratës së punës. Kriteret e lidhjes së kontratës së punësimit do të jenë në pajtim me parimet bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore dhe nënligjore.

Neni 15

Aktiviteti financiar i shoqërisë fillon me fillimin e aktivitetit tregtar dhe përfundon në muajin Dhjetor të çdo viti.

Brënda tremujorit të parë të vitit pasardhës, shoqëria duhet të nxjerrë bilancin.

Dispozita të fundit

Neni 16

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me tekstin "UNIEURO"shpk , e shkruar për rreth saj.

Neni 17

Për rastet e shndërrimit të shoqërisë në forma të tjera, apo të shpërbërjes së saj, si dhe mënyra e likuidimit, në rast se nuk përcaktohet në statut, zbatohen kriteret e përgjithshme të përcaktuar në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 18

Mosmarrveshjet midis ortakëve, midis shoqërisë dhe personave të punësuar, që nuk janë ortakë, si dhe ato midis shoqërisë dhe personave të tretë (fizikë apo juridikë), në rast se nuk zgjidhen në rrugën e mirëkuptimit të ndërsjelltë, do të zgjidhen gjyqësisht.

Kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrveshjeve, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 19

Akti-Themelimi, përpilohet me vullnetin e lirë të ortakëve themelues, nënshkruhet rregullisht prej tyre dhe hartohet në 4 kopje, me fuqi të barazvlefshme.

ORTAKET THEMELUES

Altin Bejko

Arjan Gjyzeli




STATUTI



I SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "UNIEURO" sh.p.k.

Sot më dt. 04/06/2007, ne shtetasit shqiptarë:

1-Altin Bejko, i biri i Avdylit dhe i Engjellushes, i dtl.1974, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

2-Arjan Gjyzeli, i biri i Skenderit dhe Hatixhes i dtl.1974, banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

mbështetur në dispozitat e ligjit nr.7512, dt.10/8/1991 dhe ligjit nr.7638, dt.19/11/1992, përpiluar dhe nënshkruar Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "UNIEURO" sh.p.k. me përmbajtjen e mëposhtme:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Neni 1

Shoqëria emërohet "UNIEURO" sh.p.k.

Neni 2

Selia (vend qëndrimi) e shoqërisë tregtare private "UNIEURO" sh.p.k. do të jetë në Durrës, në lagjen 17, rruga "Hysen Kertusha" ish U.R.T.

Ajo mund të hapë degë apo filiale brënda apo jashtë vëndit, në varësi të aktivitetit të saj fitimprurës, duke zbatuar dispozitat ligjore përkatëse, apo legjislacionin e vëndit të huaj, ku ajo do të hapet.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e papërcaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë kur egzistojnë kushtet ligjore, apo në marrveshje midis të gjithë ortakëve. Kur marrveshja midis ortakëve nuk arrihet, konfliktet zgjidhen nga gjykata.

Neni 4

Aktiviteti tregtar i shoqërisë do t'i nënshtrohet legjislacionit përkatës të shtetit shqiptar, ndërsa në rast të hapjes së degëve apo të filialeve jashtë vëndit, do t'i nënshtrohet legjislacionit të vëndit përkatës.

Shoqëria e fiton personalitetin juridik, nga momenti i rregjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import-eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakice.
- Prodhim e tregëtim konfeksionesh të të gjitha llojeve.
- Tregëtim artikujsh të ndryshme industriale.

- Tregëtim artikujsh të ndryshëm ushqimorë.
- Tregëtim makinerish të ndryshme e pajisje industriale e bujqësore dhe venjen e tyre në shfrytëzim.
- Tregëtim pajisjesh elektroshtepiake, kompjuterike, higjienosanitare, prodhime qeramike, artizanati etj.
- Tregëtimin e pllakave.
- Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashtë vendit.
- Tregëtimin e materialeve të ndërtimit e lendeve të para brenda dhe jashtë vendit.
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Punime duroalumini e tregëtimin e tyre.
- Punime druri, tregëtim prodhimesh të ndryshme druri, mobilje, orëndi, dyer, dritare etj.
- Stampim faqe letre dhe amballazhe të tipeve të ndryshme
- Përgatitje zarfesh letre
- Ngjitje dhe përgatitje zarfesh plastik dhe amballazhe të tipeve të ndryshme, me proces stampimi me shtypje në të nxehtë.
- Shitje me pakice dhe shumice artikujsh publicitare zarfesh prej letre, kartoni dhe plastik dhe materiale për amballazhim të tipeve të ndryshme.
- Import -eksport të kafshëve dhe shpendeve të gjalla.

Neni 6

Ndryshimi i emërimit, selisë dhe veprimtarisë së shoqërisë, do të bëhet në mënyrën e parashikuar në ligj, dhe me vendim të asamblesë së ortakëve, duke pasqyruar këto ndryshime në Rregjistrin Tregtar.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISE

Neni 7

Kapitali i shoqërisë (kapitali themeltar), do të jetë në shumën 100.000 lekë. Kapitali themeltor zotërohet nga ortakët si më poshtë:

1-Altin Bejko 50%

2-Arjan Gjyzeli 50%

Kapitali themeltar ndahet në pjesë të barabarta nga 1.000 (njëmijë) lekë, ose shumëfishin e saj. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kapitali fillestar mund të shtohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

Në kapitalin e shoqërisë përfshihet si kapitali fillestar, ashtu edhe makineritë dhe pajisjet, pasuria e luajtëshme apo e paluajtëshme, që ortakët mund të vënë si shtim të kapitalit shoqërisë.

Neni 8

Pjesët e kapitali themeltar mund t'u transferohen ortakëve apo personave që nuk janë ortakë në shoqëri, në përputhje me kërkesat e nenit 47 dhe 49 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 9

Shoqëria ka të drejtë lërë peng, pjesë të kapitalit të saj themeltar, sipas përcaktimeve të nenit 48 të ligjit bazë.

Neni 10

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, do të ndahet në raport me përqindjet e kapitalit, të vënë nga ortakët themelues. Shoqëria nga fitimi neto, cakton një fond rezervë për përballimin e situatave.

Neni 11

Ortakët përballojnë nga humbjet, vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.

Shoqëria nuk përgjigjet për borxhet apo detyrimet e ortakëve para krijimit të saj, apo për detyrimet që vijnë, si rezultat i veprimtarsë së tyre, jashtë shoqërisë.

Neni 12

Për regjistrimin e kapitalit themeltar, shoqëria do të hapë librin e llogarisë, ku do të pasqyrohen edhe ndryshimet e mundshme të kapitalit.

Ajo do të pasqyrojë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera, bilancet përkatëse dhe të gjithë aktivitetin e saj financiar.

Neni 13

Shoqëria rezervon të drejtën e tërheqjes së kredive nga bankat vëndase apo të huaja, duke vendosur për shlyrjen e tyre garanci, si dhe duke respektuar të gjitha rregullat financiare për këtë qëllim.

Neni 14

Shoqëria është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta materiale ose jo materiale, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e shitjes së pasurisë së saj tek të tretët.

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje, për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e shoqërisë dhe të mos dëmtojnë interesat e shoqërisë dhe të personave të tretë.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 15

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Asambleja e ortakëve.

Administratori

Neni 16

Asambleja e ortakëve vendos për çështjet më të kryesore të shoqërisë si:

- Përcakton drejtimit e aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- Miraton bilançet dhe politikat tregtare.
- Vendos për hapjen e degëve apo filialëve brënda apo jashtë vëndit.
- Vendos për shtimin apo pakësimin kapitalit të shoqërisë si dhe lënien peng.
- Vendos për ndryshimet eventuale të statutit si dhe pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.

-Emëron dhe shkarkon administratorët e shoqërisë.
 Aktivitetin e saj ligjor, Asambleja e ortakëve e bazon në dispozitat e neneve 57 e vijues të ligjit
 "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 17

Administrator i shoqërisë është Altin Bejko, i cili ngarkohet të kryejë dhe ndjeke të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e shoqërisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Administratori përgjigjet për drejtimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë.

Administratori do të drejtojë dhe përfaqësojë shoqërinë në lidhje me aktivitetin ekonomik dhe tregtar të shoqërisë, për gjetjen e tregjeve, lidhjen e kontratave dhe çdo gjë tjetër në këtë drejtim.

Administratori do të ndjek drejtimin financiar të shoqërisë, si dhe përfaqësimin e saj përpara organeve shtetërore dhe gjyqësore.

Neni 18

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, me detyrën e administratorit të shoqërisë, mund të emërohet dhe një person tjetër fizik që nuk është ortak në shoqëri.

Administratori jo ortak ka për detyrë të administrojë mirë pasurinë e shoqërisë, të zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë, të përgjigjet për dëmet që mund t'i sjellë shoqërisë me dashje apo nga pakujdesia, të bëjë propozime për gjithshka që është në interes të shoqërisë, si dhe ka të drejtë të paguhet për punën që kryen, në bazë të marrveshjes me shoqërinë.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQËRISË

Neni 19

Shoqëria ka të drejtë të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka, në përputhje me objektin e veprimtarisë, të sigurojë pasurinë e vet, të përfitojë nga favore të nje legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe taksat, të investojë kudo në Shqipëri nga të ardhurat që realizon, të punësojë punonjës apo specialistë vendas apo të huaj, të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 20

Shoqëria ka për detyrë të sigurojë kapitalin themeltar në formën dhe kohën e duhur, të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria, të sigurojë punonjësit e saj, të plotësojë detyrimet fiskale që ka ndaj shtetit, si dhe detyrimet kontraktuale, të respektojë standartet, si dhe të gjithë rregullat që kanë lidhje me veprimtarinë e saj.

MARDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE TE SHOQËRISË

Neni 21

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

Veprimtaria financiare e shoqërisë fillon me 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të po atij viti. Bilançi i çdo viti duhet të dalë brenda dt.31/Mars të vitit pasardhës.

Neni 22

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, shoqëria pasi bën zbritjet e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi rezervë, derisa ky fond të arrijë në masën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 23

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër dhe të pagimit të detyrimeve fiskale, u mbeten ortakëve të shoqërisë, të cilët i ndajnë në raport me përqindjet e vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Konvertimin e monedhës së realizuar nga aktiviteti i shoqërisë, do të bëhet sipas kushteve që do të ketë Banka e Shtetit Shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do të bëhet në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 24

Mardhëniet e shoqërisë me të punësuarit do të rregullohen në bazë të kontratës së punës. Ajo do të jetë në konformitet me frymën e legjislacionit të Kodit të Punës dhe do të përmbajë kryesisht, llojin e punës apo të profesionit, mënyrën e shpërblimit, kohën e punës dhe të pushimit, rastet e largimit nga puna dhe elementë të tjerë të saj.

DISPOZITA TE VECANTA

Neni 25

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me tekstin "UNIEURO" shpk, e shkruar për rreth saj.

Neni 26

Shndërrimi i shoqërisë në formë të tjerë të shoqërisë tregtare, të parashikuar nga ligji nr.7638, dt.19/11/1992, bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 57 të këtij ligji.

Neni 27

Shoqëria nuk priset, kur vdes, çfaq paaftësi apo falimenton njëri prej ortakëve. Në rast vdekje të njërit prej ortakëve, aktivitetin e vazhdojnë trashëgimtarët ligjorë që dalin në bazë të vendimit të gjykatës.

Neni 28

Për të gjitha rastet e paparashikuara në statut apo të parashikuara shkurtimisht, do të interpretohen në konformitet me kërkesat e ligjit 7638, dt.19/11/1992, "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 29

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çdo shkak, si:
 -Humbje e kapitalit të shoqërisë.
 -Pamundësi veprimi.

-Me vendim të asmblesë të pranuar nga të gjithë ortakët.

Në këto raste vendoset mbi mënyrën e likuidimit të shoqërisë dhe caktohen një ose më shumë likuidatorë, duke u caktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë, deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizik apo juridik, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Neni 30


Mosmarrveshjet eventuale që mund të lindin midis ortakëve, midis shoqërisë dhe të punësuarve, si dhe midis shoqërisë dhe personave të tretë me të cilët shoqëria ka hyrë në marrdhënie, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 31

Statuti është hartuar me vullnetin e lirë të palëve, është përpilua në 4 kopje me fuqi të barazvlefshme dhe është nënshkruar rregullisht në prezencë të Noterit.

ORTAKET THEMELUES

Altin Bejko



Arjan Gjyzeli

